



VENDIM PARAPRAK

Nr. 22, Datë 09/05/2017

MBI

**PAJISJEN E ISH – STUDENTIT MIRIAN SERICA NË FAKULTETIN E MUZIKËS,
PROGRAMI I STUDIMIT PIANO ME DIPLOMË MODEL
"TË INTEGRUAR TË NIVELIT TË DYTË", NGA UNIVERSITETI I ARTEVE SIPAS
VENDIMIT NR.1054, DATË 03.03.2015, TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË –TIRANË QË: "UNIVERSITETI I ARTEVE TË PAJISË ME
DIPLOMË TË "INTEGRUAR TË NIVELIT TË DYTË", PADITËSIN Z. MIRIAN SERICA"
DHE VENDIM NR.679 (86-2017-627), DATË 17.02.2017, TË GJYKATËS
ADMINISTRATIVE TË APELIT - TIRANË, QË KA VENDOSUR: "LËNIA NË FUQI E
VENDIMIT NR.1054 DATË 03.03.2015, TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË TIRANË"**

Në zbatim të, nenit 38, (Funksionet e Senatit Akademik), të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit Nr.1054, datë 03.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë –Tiranë që: "Universiteti i Arteve të pajisë me diplomë të **"Integruar të Nivelit të Dytë"**, paditësin z. Mirian Serica" dhe Vendim Nr.679 (86-2017-627), datë 17.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit - Tiranë, që ka vendosur: "Lënia në fuqi e vendimit nr.1054 datë 03.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë", **mos** "Pezullimi i ekzekutimit të titullit të ekzekutimit Vendimit nr.1054, datë 03.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.679, datë 17.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit – Tiranë", nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, datë 4 maj 2017, Relacioni i Rektorit Prof. Kastriot Çaushti,

VENDOSI

1. Miratimin paraprak të diplomës model të "Integruar të Nivelit të Dytë", për ish – studentin Mirian Serica, të Fakultetit të Muzikës, programi i studimit "PIANO", bashkëlidhur listën e notave, sipas titullit ekzekutiv, "Vendimit Nr.1054, datë 03.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë –Tiranë".
2. Ky vendim ti dërgohet MAS, për veprime sipas legjislacionit në fuqi;
3. Bashkëlidhur, Vendimi Nr.1054, datë 03.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë – Tiranë që: "Universiteti i Arteve të pajisë me diplomë të "Integruar të Nivelit të Dytë", paditësin z. Mirian Serica" dhe Vendim Nr.679(86-2017-627), datë 17.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit - Tiranë, që ka vendosur: "Lënia në fuqi e vendimit nr.1054 datë 03.03.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë";

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA



UNIVERSITETI I ARTEVE



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
UNIVERSITETI I ARTEVE



DIPLOMË

E INTEGRUAR E NIVELIT TË DYTË

në _____ mbështetur në vendimin Nr.1054 datë 03.03.2015
të Gjykatës Administrative të shkallës së parë Tiranë që: Universiteti i Arteve të pajisë me diplomë të
"Integruar të Nivelit të Dytë"

Z. _____

lënë në fuqi me vendimin Nr. 679 (86-2017-627), dt. 17.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Lindur në _____ më _____, regjistruar në Fakultetin e Muzikës më datë _____

Data e mbrojtjes së diplomës _____, data e lëshimit të diplomës _____

Numër Diplome: _____ Numër matrikullimi _____

Diploma shoqërohet me listën e notave

DEKANI

REKTORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË



Nr.Regj.Them 8587/833
Data e Regjistrimit 10.11.2014

Nr. Vendimit 1054
Data 03.03.2015

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTAR: GENTIAN HAMITI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Entela Shkreta**, në datë 03.03.2015, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të çështjes administrative që i përket:

PADITES: Mirian Serica, i datëlindjes 10.06.1985, lindur dhe banues në Elbasan, përfaqësuar me prokurë të posacme nga avokate Fiona Tako.

TË PADITUR: Fakulteti i Muzikes prane Universitetit te Arteve (në mungesë).

Rektorati i Universitetit te Arteve (në mungesë).

Universiteti i Arteve, përfaqësuar me autorizimin e dates 04.12.2014 nga juristi

Vladimir Dhamo.

OBJEKTI: Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të grupit të vlerësimit të ofertave datë 02.10.2012. Detyrimi i palës së paditur per te me pajisur me Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.9741, date 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", I ndryshuar; Ligji Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative".

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata si dëgjoi palën e paditur e cila kërkoi pranimin e padisë, palën e paditur e cila kërkoi rrëzimin e padisë, si shqyrtoi provat e bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Se paditësi Mirian Serica ka paraqitur para kësaj gjykate kërkespadinë me objekt; Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të grupit të vlerësimit të ofertave datë 02.10.2012. Detyrimi i palës së paditur per te me pajisur me Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte.

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se. në vitin akademik 2004-2005, z.Mirian Serica ka filluar studimet pranë Fakultetit të Muzikës në programin e studimit piano, duke ndjekur ciklin katër vjecar të studimeve prane Universitetit te Arteve, deri në vitin akademik 2010-2011. Pasi ka shlyer të gjitha provimet e parashikuara nga cikli i studimeve, paditësit i ka mbetur pa shlyer provimi i diplomës.

Senati Akademik i Universitetit të Artave ka marrë vendimin nr.21 datë 26.06.2012 "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentët që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomës, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2 në Universitetin e Artave". Në bazë të këtij vendimi, Grupi i Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës ka përcaktuar kreditet e

VERTETOHET NJESIA
ME ORIGINALIN
K/SEKRETARE
SELVANA GOGO

paditësit për katër vite studimi në Fakultetin e Muzikës. Konkretisht me shkresën e datës 02.10.2012, paditësi është vlerësuar me 196 kredite. Ky vlerësim është kundërshtuar nga paditësi nëpërmjet kërkesës ankimore drejtuar Fakultetit të Muzikës.

Nga Rektori i Universitetit të Arteve është nxjerrë urdhëri nr.29 datë 11.06.2013 të "Mbi modalitetet për shënien e diplomës për disa studentë që kanë kryer studimet me sistemin katër vjeçar të studimeve në universitetin e arteve", pjesë e të cilit është dhe studentja Miriam

Lidhur me problemin e diplomimit, paditësi ka paraqitur kërkesa ankimore si në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ashtu dhe pranë Rektorit të Universitetit të Arteve. Me shkresën nr.1032/1 prot datë 20.06.2014, Rektori i Universitetit të Arteve i ka kërkuar Dekanin të Fakultetit të Muzikës që të merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të z.Mirian Serica.

Në datë 05.02.2014, paditësi rezulton të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Për këtë fakt është mbajtur procesverbali i mbrojtjes së diplomave për ciklin e dytë "Master i Arteve të Bukura" viti akademik 2013-2014. Megjithatë ka shlyer dhe provimin e diplomës, paditësi nuk është pajisur me diplomë.

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës duke pretenduar në mënyrë të përinbledhur se: konvertimi i provimeve të dhena, është në kundërshtim të hapur me ligjin, pasi ky lloj konvertimi është i pamundur, duke qenë se paditësi është regjistruar në një program të caktuar, atë 4 vjeçar, duke marrë dhe numrin e amzes perkates, që identifikohet pikërisht me këtë sistem, dhe për më tepër ka shlyer të gjithë provimet me këtë sistem, duke mbetur pa likujtuar vetëm Diploma, për të cilën madje ishte regjistruar dhe kishte kiyer dhe pagesen perkatese. Nenet 99/1 dhe 99/2 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, rregullojnë me se miri situatën e paditësit, pasi ato parashikojnë shprehimisht se studentet e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet me të njëjtin program studimi dhe në përfundim do të pajisen me diplome sipas këtij ligji, në përshatje me programin e studimeve të kryera. Në rastin konkret, Mirian Serica ka shlyer të gjithë detyrimet e provimeve, duke përfunduar ciklin e studimit dhe duhej të shlyente vetëm diplomën. Vendimi i mesipër të Komisionit të Vlerësimit të Krediteve është absolutisht i pavlefshëm pasi ky komision, në vendimmarrjen e tij, ka vepruar në mënyrë arbitrare në vlerësimin e krediteve, duke mos dhënë asnjë sqarim lidhur me mënyrën e përlogaritjes së tyre dhe metodologjinë e ndjekur për këtë qëllim. Komisioni, për student të ndryshëm, të ndodhur në të njëjtën situatë si paditësi Mirian Serica, ka bërë vlerësim të ndryshëm kreditesh, duke u shkelur rëndë parimi i sigurisë juridike. Studentet e Universitetit të Arteve janë të gjithë njelloj përpara ligjit, ndaj dhe vlerësimi i tyre duhet të jetë i njëjti. Përkundrazi, në rastin konkret, paditësi, duke qenë se kishte shlyer të gjithë provimet e parashikuara nga cikli i studimeve 4 vjeçar, duhej të ishte vlerësuar me kredite të plota, duke zbritur vetëm kreditet e diplomës, që do të thote 300 kredite në total, minus 12 kredite të diplomës, studentja Serica duhej të ishte vlerësuar me 288 kredite. Paditësi e ka kundërshtuar disa herë këtë vendimmarrje, duke u krijuar dhe një situatë e rënduar midis studentit dhe fakultetit por edhe midis këtij të fundit dhe Rektoratit, i cili kerkonte të jepte zgjidhje ceshtjes. Rektori i Fakultetit, është përparë për ta zgjidhur këtë ngerc, për shkak se nga shkresat e tij drejtuar Dekanin del qartë mendimi se me paditësin ishte vepruar gabim, por, duke patur një konflikt midis dy drejtuesve, i cili u vertetua pas pezullimit nga detyra të Dekanin të Fakultetit të Muzikës, ceshtja nuk ka mundur të marrë zgjidhje. Në fund, pas gjithë veshtiresive të siperpërmendura dhe shkresave ankimore të derguara nga i përfaqësuarin në Dekanat, Rektorat dhe madje edhe në Ministrinë e Arsimit për 3 vite me rradhe, duke kërkuar një të drejtë që i takon, në muajin Janar të vitit 2014, paditësi është njoftuar nga sekretaria e

Fakultetit të Muzikës se ai do të futej në provimin e diplomes dhe për këtë arsye i është kërkuar të përgatiste temën e diplomes, të paraqiste deshmime të mbrojtjes së gjuhës angleze dhe të paguante takson përkatës. Tema e diplomes, në përputhje me ligjet dhe statutin, pasi u përgatit, u konfirmua duke u nënshkruar pedagogia e lëndës, përkatësisht znj. Rudina Ciko dhe shefi i departamentit, z. Fatos Qerimi. Paditesi ka vepruar ekzaktesisht sic i është kërkuar dhe në datë 05.02.2014 fakulteti ka bërë të mundur që paditësi të likujdojë Diplomen, ku dhe është vlerësuar nga komisioni i caktuar për këtë qëllim me notën 9. Në përberje të komisionit kanë qenë të gjithë pedagogët e katedrës së piano: Rudina Ciko, Nora Cashku, Merita Rexha Tershana, Ina Petrollari Laco, si dhe 2 pedagogë të jashtëm: Mirela Sykja, dhe Silva Skenderi. Paditesi ka kryer pagesën e krediteve dhe në ditën e caktuar nga sekretaria e fakultetit, e cila merret me menaxhimin e dosjeve të studenteve dhe menaxhimin e çështjeve administrative, është paraqitur përpara komisionit të ngritur për vlerësimin e studenteve pjesëmarrës. Pra, me gjithë se paditesi ka mundur të likujdojë provimin e diplomes, serish ka hasur vështirësi në pajisjen me Diplomen në fjalë dhe suplementin përkatës. Ende edhe sot nuk i është vënë në dispozicion kartoni i diplomes së bashku me suplementin, për programin e studimeve në të cilin është regjistruar dhe ka përfunduar studimet, pra ai 4 -vjeçar, që në veshtrim të nenit 99/2 të ligjit për Arsimin e Lartë të sipërcituar, duhet të konvertohet në Diplome të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND). Për këtë qëllim, me datë 06.09.2014, paditësi i është drejtuar me kërkesë të posaçme Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve, duke i kërkuar atyre të dëjmi me një Vendim në formën e parashikuar nga ligji dhe të arsyetuar, lidhur me çështjen në fjalë, por, të dy palet e paditura nuk kanë marrë një vendim të tillë, ndaj në jemi të detyrur të drejtohem gjykatës për zgjidhjen e këtij konflikti, duke kërkuar pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

Pala e paditur, Universitetit të Arteve, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se: Paditesi duhet të kishte përfunduar studimet në vitin mesimor akademik 2007 - 2008. I përfundoj sipas kërkesës përkatëse, së bashku me "tezen e diplomes", me 17.02.2014. E marrim të mirëqenë mbrojtjen e tezes së diplomes. Diploma që i takon nga UART, paditesit, do të jepet sipas nenit 26, të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Pra diplome "BACHELOR" ose "MASTER", i Arteve të Bukura, shoqeruar me Suplementin e Diplomes. Raport /relacion i cili konsiderohet nga paditësi si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, është i mbështetur teresisht në legjisllacionin në fuqi. dhe se ky Raport /relacion, nuk mund të vërehet edhe nga VSA nr.21, datë 26.06.2012, "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga student që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomes, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2, në Universitetin e Arteve. Sipas pikës 1, të VSA, datë 26.06.2012: "Studentet e përcaktuar nga GVK për të diet është bërë vlerësimi i krediteve dhe është përcaktuar përshtatshmëria për vazhdimin e studimeve, kanë të drejtë të regjistrohen në vitin e studimeve të ciklit të dytë, për të cilin kanë plotësuar numrin e krediteve të kërkuara". Paditesit i është dhënë përgjigje e arsyetuar, duke konkluduar që: plotëson kriteret për t'u paisur nga Universiteti i Arteve, me "Diplome Universitare "BACHELOR", shoqeruar me Suplementin e Diplomes, pasi të mbroje edhe tezen e diplomes, sipas relacionit të GVK, të FM, datë 02.10.2012. Vendimi i Senatit Akademik nr.21, datë 26.06.2012, "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentet që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomes, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2, në Universitetin e Arteve dhe Relacionet e GVK, të tre fakulteteve, etj. janë dokumente që janë hartuar në sintoni të plotë edhe me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 19.03.2008. Paditesi kërkon "Diplome të Integruar të Nivelit të Dytë", por Universiteti i Arteve nuk e jep dot këtë diplomë se e pengon, nëni 99/2, i Ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Paditësi i është drejtuar gjykatës tej afatit të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr.49/2012. Procesverbali i cili është paraqitur në cilësinë e provës, është i dyshimtë dhe shumë i qabuar, nga personat që e kanë mbajtur, ku nuk rezulton të këtë datë, që nuk ka vlerësim me note nga Kryetari i Komisionit të provimit, nuk ka numrin e

krediteve të fituara nga studenti, që tregojnë se studenti Mirian Serica është tentuar të futet në provim të "mbroje" tezen për diplome "Master", dhe jo për diplome Bachelor sipas krediteve të fituara. Ky procesverbal nuk është i miratuar nga Dekani i FM, mbas datës 17.02.2012. Ky procesverbal i dyshimte por edhe i denueshëm, ka mangësi në përmbajtje por edhe në formën e kërkuar sipas nenit 43, pika 2, germa "g" e Statutit të UART. Në këtë procesverbal të dyshimte, pasqyrohen vlerësimet me notën 9-te, (te paditsit), nga anëtarët e komisionit, por jo nga Kryetari i komisionit. Ky procesverbal është një dokument i pavlefshëm. Mungesa e Kryetarit, në komision në ditën e mbajtjes së këtij procesverbal për z. Mirian Serica, gjykojmë e ben të pavlefshëm gjithë veprimtarinë e anëtarëve të komisionit. Ky procesverbal është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. -Sipas Udhezimit nr.15, datë 4.4.2008, të MASH, "Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", kapitulli IV, (fitimi i diplomave të studimit) pika 3:" Për të fituar një diplomë të integruar të nivelit të dytë studenti duhet të ketë grumbulluar së paku 300 kredite". Në analizë të këtyre kërkesave më të larta kemi para faktit: Kredite të fituara, nga paditësi mirian Serica, që paditësi i pranon në kërkesë padinë e tij janë 196 kredite: Teza e diplomes, sipas rregullores mesimore të UART, vlerësohet 30 kredite: Totali i krediteve, për paditësin Mirian Serica, rezultojnë gjithsej 226 kredite. Për të përfituar një diplomë të integruar të nivelit të dytë, studenti duhet të ketë 300 kredite. Sipas llogarive paditësi rezulton të ketë 226 kredite, pra edhe me këtë llogaritje të supozuar, paditësi nuk e përfiton këtë diplomë. Pra padia është e pambështetur në ligj dhe prova dhe si e tillë ajo duhet rëzuar.

Në lidhje me bazueshmërinë e kërtimeve të paditësit gjykata i referohet ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Nga Senati Akademik i Universitetit të Artave është marrë vendimi nr.21 datë 26.06.2012 "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentët që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomës, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2 në Universitetin e Artave".

Në bazë të këtij vendimi, Grupi i Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës ka përcaktuar kreditet e paditësit për katër vite studimi në Fakultetin e Muzikës. Konkretisht me shkresën e datës 02.10.2012, paditësi është vlerësuar me 196 kredite. Ky vlerësim është kundërshtuar nga paditësi nëpërmjet kërkesës ankimore drejtuar Fakultetit të Muzikës. Këtë shkresë paditësi e konsideron një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, dhe për këtë kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij.

Në nenin 2 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", jepet kuptimi i aktit administrativ individual.

Sipas këtij neni; "*Akt administrativ individual*" është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete".

Shkresa e datës 02.10.2012 të Grupit të Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës, nuk krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet akt administrativ individual. Në këto kushte, gjykata nuk mund të ndryshojë një shkresë të thjeshtë e cila nuk konsiderohet akt administrativ, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Pra kërkimi i parë i paditësit që ka të bëjë me

deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të grupit të vlerësimit të ofertave datë 02.10.2012, është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Përsa i përket kërkingjve të tjerë të paditësit që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur për ta pajisur me Diplome të Integruar të Nivelit të Dytë, gjykata i referohet Ligji nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e misionit, objektivave kryesore të arsimit të lartë dhe rregullimin e aspekteve të krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit, sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet evropiane, si dhe rolin e shtetit e të shoqërisë në arsimin e lartë. Nëpërmjet këtij ligji është shfuqizuar ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".

Në rastin konkret paditësi është regjistruar në programin e studimit pranë Fakultetit të Muzikës, në vitin akademik 2004-2005, pra në kohën kur ka qenë në fuqi ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit nr.8461/1999, programi i studimit në këtë fakultet ka qenë katër vite akademike.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", ka ndryshuar programi i studimit si dhe diplomat e studimeve universitare. Por në këtë ligj janë parashikuar dispozita kalimtare, për studentët e regjistruar në një program studimi para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konkretisht në nenin 88 të këtij ligji parashikohet se: *Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij. Studentët mbetës do të marrin një diplomë në varësi të afateve të studimeve të tyre dhe kurrikulës.*

Të njëjtin përcaktim bën dhe neni 99/1 i ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në të cilin parashikohet:

- 1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi, për kohëzgjatjen e parashikuar të tij, dhe në përfundim do të pajisen me diplomë, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në përshtatje me programin e studimit të kryer.*
- 2. Institucionet e arsimit të lartë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtatin emërtimet e diplomave, që i përkasin programeve të studimeve në vijim dhe t'i depozitojnë për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.*

Në referim të këtyre dispozitave, paditësi rezulton të jetë regjistruar në programin e studimit katër vjeçar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe për rrjedhojë studimet e tij duhet të vazhdonin me të njëjtin program studimi (katër vjeçar). Këtë konkludim gjykata e mbështet dhe në Vendimin nr.6 viti 2012 i Gjykatës Kushtetuese, në të cilin citohet se: *Gjykata vëren se parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese).*

Në këndvështrim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, ligji nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise" duhet të rregullojë marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tij në fuqi, ndërsa marrëdhënia juridike objekt konflikti gjyqësor duhet të gjej rregullim në dispozitat kalimtare të këtij ligji, sipas të cilave studimet e paditësit duhet të vazhdojnë me të njëjtin program studimi (katër vjecar).

Po kështu, në datë 05.02.2014, paditësi rezulton të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Për këtë fakt është mbajtur procesverbali i mbrojtjes së diplomave për ciklin e dytë "Master i Arteve të Bukura" -viti akademik 2013-2014, duke i lindur në këtë mënyrë, është për tu pajisur me diplomë.

Në lidhje me këtë procesverbal, pala e paditur ka prapësuar se është i pavlefshëm/i parregullt. Këtë prapësim gjykata e gjen të pabazuar, pasi nuk konstaton element të pavlefshmërisë apo parregullsisë së tij. Gjithsesi, edhe nëse do të pranohet pavlefshmërinë/parregullsinë e procesverbalit, gjykata vlerëson se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë paditësit. Me fjalë të tjera, rreziku i ndonjë gabimi të kryer nga autoritetet shtetërore, duhet të mbulohet nga shteti. Gabimet nuk duhet të paguhen nga individ i përfshirë në çështje (vendimi Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, çështja: Radchikov k. Ruisisë, § 50).

Përsa i përket llojit të diplomës me të cilën duhet të pajisen studentët e regjistruar në programin e studimit katër vjecar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", gjykata i referohet nenit 89 të këtij ligji, ku përcaktohet ekuivalentimi i diplomave, sipas kohës së zgjatjes së programeve të studimit. Në këtë dispozitë parashikohet se:

Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur 3 vite (6 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat e nivelit të parë.

Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë.


Diplomat e fituara në studimet në kuadër të "Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara" janë ekuivalente me diplomat "Master i Nivelit të Dytë".

Pra, sipas kësaj dispozite, diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, sic është dhe rasti i paditësit, janë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë. Duke qenë se studimet e paditësit kanë zgjatur katër vite akademike, në përfundim të të cilave është shlyer dhe provimi i diplomës, atëherë atij (paditësit) i lind e drejta që të diplomohet me diplomë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë.

Sa më sipër gjykata konkludon se, kërkimi i paditësit që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur per ta pajisur me Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte, gjendet i bazuar në prova dhe në ligjin nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise" dhe si i tillë duhet pranuar, duke detyruar Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin me diplomë të integruar të nivelit të dytë, kjo në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", në të cilin parashikohet se; 1. Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos: ç) detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë.

Përsa i përket palëve të paditura, Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve, padia duhet rrëzuar për mungesë të legjitimitetit pasiv, pasi këto palë nuk gëzojnë personalitet juridike, por janë njësi të Universitetit, dhe si të tilla nuk mund të ngarkohen me një detyrim konkret.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar pjesërisht duke detyruar palën e paditur Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin e me diplomë të integruar të nivelit të dytë, ndërsa për kërkimet e tjera padia duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe prova.




PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 40, 41, 42 të ligjit nr. 49 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", nenet 306-310 të K.Pr.Civile.

VENDOSI

- Pranimin e pjesëshëm të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin me diplomë të integruar të nivelit të dytë.
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.
- Rrëzimin e padisë për palët e paditura Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve, për mungesë të legjitimitetit pasiv.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit për pjesën e pranuar të padisë ndërsa për pjesën e rrëzuar i ngarkohen paditësit.
- Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga Zyra Përmbarimore.
- Ngarkohet Zyra Përmbarimore të ekzekutojë plotësisht detyrimin nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit ndërsa për palët në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni.
- U shpall sot më datë 03.03.2015, Tiranë.

**SEKRETARE
ENTE LA SHKRETA**



Shpenzimet gjyqësore	
- Takse kerkese padie	3000 leke
- Takse njoftimi	200 leke
GJITHSEJ;	3200 LEKE


VERTETONE NJESIA
ME ORIGINALIN
K/SEKRETARE
SELVANA GOGO

Shenim: Gjykata Administrative e Apelit Tirane me vendimin nr.679(86-2017-627) date 17.02.2017 ka vendosur:

- Lenien ne fuqi te Vendimit nr. 1054, date 03.03.2015 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane.
- Kunder ketij vendimi lejohet rekurs ne Kolegjin Administrativ te Gjykates se Larte, brenda 30 diteve afat qe fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit.

Tirane me 15.03.2017

**K/SEKRETARE
SELVANA GOGO**



VERTETUHE NJESIA
ME ORIGINALIN
K/SEKRETARE
SELVANA GOGO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 8582/5998/1798(31017-02309-86-2015) Regjistri Themeltar
Datë 20.04.2015 regjistrimi

Nr.679(86-2017-627)Vendim
Datë 17/02/2017



V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

GJYQTAR : Kastriot SELITA

GJYQTARE : Bernina KONDI

GJYQTARE : Altina NASUFI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Almeida Cllini, në Tiranë në datë 17.02.2017 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr.8582/5998/1798(31017-02309-86-2015) regjistri themeltar, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS : Mirian Serica, i datëlindjes 10.06.1985, lindur dhe banues në Elbasan.

TË PADITUR : Fakulteti i Muzikes prane Universitetit te Arteve.
Rektorati i Universitetit te Arteve.
Universiteti i Arteve.

OBJEKTI : Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të grupit të vlerësimit të ofertave datë 02.10.2012. Detyrimi i palës së paditur për të me pajisur me Diplome të Integruar të Nivelit të Dytë.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.9741, date 21.05.2007 “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise”, I ndryshuar; Ligji Nr.49/2012 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.1054 datë 03.03.2015 ka vendosur:

- Pranimin e pjesshëm të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin me diplomë të integruar të nivelit të dytë.
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.
- Rrëzimin e padisë për palët e paditura Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve, për mungesë të legjitimitetit pasiv.

- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit për pjesën e pranuar të padisë ndërsa për pjesën e rrëzuar i ngarkohen paditësit.
- Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga Zyra Përmbartimore.
- Ngarkohet Zyra Përmbartimore të ekzekutojë plotësisht detyrimin nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit ndërsa për palët në mungesë ky afat fillon nga e nesërmeja e marrjes së dijenit.

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim pala e paditur, Universiteti i Arteve duke kërkuar ndryshimin e Vendimit datë 03.03.2015 dhe rrëzimin e padisë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, me vendim ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur në gjykim.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës **Bernina Kondi**, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I.Rrethanat e çështjes:

Ka rezultuar se, në vitin akademik 2004-2005, z.Mirian Serica ka filluar studimet pranë Fakultetit të Muzikës në programin e studimit piano, duke ndjekur ciklin katër vjeçar të studimeve pranë Universitetit të Arteve, deri në vitin akademik 2010-2011. Pasi ka shlyer të gjitha provimet e parashikuara nga cikli i studimeve, paditësit i ka mbetur pa shlyer provimi i diplomës.

Senati Akademik i Universitetit të Artave ka marrë vendimin nr.21 datë 26.06.2012 "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentët që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomës, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2 në Universitetin e Artave". Në bazë të këtij vendimi, Grupi i Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës ka përcaktuar kreditet e paditësit për katër vite studimi në Fakultetin e Muzikës. Konkretisht me shkresën e datës 02.10.2012, paditësi është vlerësuar me 196 kredite. Ky vlerësim është kundërshtuar nga paditësi nëpërmjet kërkesës ankimore drejtuar Fakultetit të Muzikës.

Nga Rektori i Universitetit të Arteve është nxjerrë urdhëri nr.29 datë 11.06.2013 të "Mbi modalitetet për dhënie të diplomës për disa studentë që kanë kryer studimet me sistemin katërvjeçar të studimeve në universitetin e arteve", pjesë e të cilit është dhe studenti Miriam Serica.

Lidhur me problemin e diplomimit, paditësi ka paraqitur kërkesa ankimore si në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ashtu dhe pranë Rektorit të Universitetit të Arteve. Me shkresën nr.1032/1 prot datë 20.06.2014, Rektori i Universitetit të Arteve i ka kërkuar Dekanin të Fakultetit të Muzikës që të merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të z.Mirian Serica.



Në datë 02.10.2014, paditësi rezulton të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me nota 5.0 (nëntë). Për këtë faktë është mbajtur procesverbali i mbrojtjes së diplomave për ciklin e dytë "Master i Arteve të Bukura" viti akademik 2013-2014. Megjithëse ka shlyer dhe provimin e diplomës, paditësi nuk është pajisur me diplomë.

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës duke pretenduar sipas obejktit të padisë si më sipër cituar.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Gjykata ka pranuar pjesërisht padinë me argumentimin si vijon;

Në lidhje me bazueshmërinë e kërkimeve të paditësit gjykata i referohet ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Nga Senati Akademik i Universitetit të Artave është marrë vendimi nr.21 datë 26.06.2012 "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentët që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomës, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2 në Universitetin e Artave".

Në bazë të këtij vendimi, Grupi i Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës ka përcaktuar kreditet e paditësit për katër vite studimi në Fakultetin e Muzikës. Konkretisht me shkresën e datës 02.10.2012, paditësi është vlerësuar me 196 kredite. Ky vlerësim është kundërshtuar nga paditësi nëpërmjet kërkesës ankimore drejtuar Fakultetit të Muzikës. Këtë shkresë paditësi e konsideron një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, dhe për këtë kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij.

Në nenin 2 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", jepet kuptimi i aktit administrativ individuale.

Sipas këtij neni; "*Akt administrativ individual" është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*".

Shkresa e datës 02.10.2012 të Grupit të Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës, nuk krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet akt administrativ individual. Në këto kushte, gjykata nuk mund të ndryshojë një shkresë të thjeshtë e cila nuk konsiderohet akt administrativ, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Pra kërkimi i parë i paditësit që ka të bëjë me deklarin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të grupit të vlerësimit të ofertave datë 02.10.2012, është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Përsa i përket kërkimit tjetër të paditësit që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur per ta pajisur me Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte, gjykata i referohet Ligji nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise".

Në rastin konkret paditësi është regjistruar në programin e studimit pranë Fakultetit të Muzikës, në vitin akademik 2004-2005, pra në kohën kur ka qenë në fuqi ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit nr.8461/1999, programi i studimit në këtë fakultet ka qenë katër vite akademike.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", ka ndryshuar programi i studimit si dhe diplomat e studimeve universitare. Por në këtë ligj janë parashikuar dispozita kalimtare, për studentët e regjistruar në një program studimi



para hyrjes në fuqi të këtij ligji, konkretisht neni 88 dhe 99/1 i ligjit nr.9741/2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH".

Në referim të këtyre dispozitave, paditësi rezulton të jetë regjistruar në programin e studimit katër vjeçar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", dhe për rrjedhojë studimet e tij duhet të vazhdonin me të njëjtin program studimi (katër vjeçar). Këtë konkludim gjykata e mbështet dhe në Vendimin nr.6 viti 2012 i Gjykatës Kushtetuese, në të cilin citohet se: *Gjykata vëren se parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese).*

Po kështu, në datë 05.02.2014, paditësi rezulton të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Për këtë faktë është mbajtur procesverbali i mbrojtjes së diplomave për ciklin e dytë "Master i Arteve të Bukura" viti akademik 2013-2014, duke i lindur në këtë mënyrë, e drejta për tu pajisur me diplomë.

Përsa i përket llojit të diplomës me të cilën duhet të pajisen studentët e regjistruar në programin e studimit katër vjeçar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", gjykata i referohet nenit 89 të këtij ligji, ku përcaktohet ekuivalentimi i diplomave, sipas kohës së zgjatjes së programeve të studimit. Pra, sipas kësaj dispozite, diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, sic është dhe rasti i paditësit, janë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë.

Sa më sipër gjykata konkludon se, kërkimi i paditësit që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur per ta pajisur me Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte, gjendet i bazuar në prova dhe në ligjin nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise" dhe si i tillë duhet pranuar, duke detyruar Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin me diplomë të integruar të nivelit të dytë, kjo në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", në të cilin parashikohet se; *1. Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos: ç) detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë.*

Përsa i përket palëve të paditura, Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit te Arteve, padia duhet rrëzuar për mungesë të legjitimitetit pasiv, pasi këto palë nuk gëzojnë personalitet juridike, por janë njësi të Universitetit, dhe si të tilla nuk mund të ngarkohen me një detyrim konkret. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar pjesërisht duke detyruar palën e paditur Universitetin e Arteve që të pajisë paditësin e me diplomë të integruar të nivelit të dytë, ndërsa për kërkimet e tjera padia duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe prova.

III. Shkaqet e parashtruara në ankimin e palës së paditur, Unversiteti i Arteve:

- Paditësi duhet ti kishte përfunduar studimet ne vitin mesimor akademik 2007 - 2008. I perfundoj sipas kerkese padise, se bashku me "tezen e diplomes", me 17.02.2014. E marim te mireqene mbrojtjen e tezes se diplomes. Diploma qe i takon nga UART,



paditesit, do ti jepet sipas nenit 26, te ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar. Pra diplome, "BACHELOR" ose "MASTER", i Arteve te Bukura, shoqeruar me Supplementin e Diplomes. Raport /relacion i cili konsiderohet nga paditesi si akt administrativ absolutisht i pavlefshem, eshte i mbeshtetur teresish ne legjislacionin ne fuqi. dhe se ky Raport /relacion, nuk mund te vecohet edhe nga VSA nr.21, date 26.06.2012, "Per disa modalitete mbi perfundimin e studimeve nga student qe nuk kane shlyer detyrimet per marrjen e diplomes, per efekt te kalimit ne sistemin e studimeve 3+ 2, ne Universitetin e Arteve. Sipas pikes 1, te VSA, date 26.06.2012: "Studentet e percaktuar nga GVK per te dijet eshte bere vleresimi i krediteve dhe eshte percaktuar pershtatshmeria per vazhdimin e studimeve, kane te drejte te regjistruhen ne vitin e studimeve te ciklit te dyte, per te cilin kane plotesuar numrin e krediteve te kerkuara".

- Paditesi i eshte dhene pergjigje e arsyetuar, duke konkluduar qe: ploteson kriteret per t'u paisur nga Universiteti i Arteve, me "Diplome Universitare "BACHELOR", shoqeruar me Supplementin e Diplomes, pasi te mbroje edhe tezen e diplomes, sipas relacionit te GVK, te FM, date 02.10.2012. Vendimi i Senatit Akademik nr.21, date 26.06.2012, "Per disa modalitete mbi perfundimin e studimeve nga studentet qe nuk kane shlyer detyrimet per marrjen e diplomes, per efekt te kalimit ne sistemin e studimeve 3+2, ne Universitetin e Arteve dhe Relacionet e GVK, te tre fakulteteve, etj. jane dokumente qe jane hartuar ne sintoni te plote edhe me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, date 19.03.2008. Paditesi kerkon "Diplome te Integruar te Nivelit te Dyte", por Universiteti i Arteve nuk e jep dot kete diplome se e pengon, neni 99/2, i Ligji nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.
- Paditesi i është drejtuar gjykatës tej afatit të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr.49/2012. Procesverbali i cili është paraqitur në cilësinë e provës, është i dyshimte dhe shume i qabuar, nga personat qe e kane mbajtur, ku nuk rezulton te kete date, qe nuk ka vleresim me note nga Kryetari i Komisionit te provimit, nuk ka numrin e krediteve te fituara nga studenti, qe tregon se studenti Mirian Serica eshte tentuar te futet ne provim te "mbroje" tezen per diplome "Master", dhe jo per diplome Bachelor sipas krediteve te fituara. Ky procesverbal nuk eshte i miratuar nga Dekani i FM, mbas dates 17.02.2012. Ky procesverbal i dyshimte por edhe i denueshem, ka mangesi ne permbajtje por edhe ne formen e kerkuar sipas nenit 43, pika 2, germa "g" e Statutit te UART. Ne kete procesverbal te dyshimte, pasqyrohen vleresimet me noten 9-te, (te paditsit), nga anetaret e komisionit, por jo nga Kryetari i komisionit. Ky procesverbal është një dokument i pavlefshëm. Mungesa e Kryetarit, ne komision, ne ditën e mbajtjes se ketij procesverbal per z. Mirian Serica, gjykojme e ben te pavlefshem gjithë veprimtarine e anetareve te komisionit. Ky procesverbal është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. -Sipas Udhezimit nr.15, date 4.4.2008, te MASH, "Per organizimin e studimeve ne Institucionet Publike te Arsimit te Larte", kapitulli IV, (fitimi i diplomave te studimit) pika 3:" Per te fituar nje diplome te integruar te niveli te dyte studenti duhet te kete grumbulluar se paku 300 kredite".
- Ne analize te ketvire kerkesave liaiore iemi para faktit: Kredite te fituara, nga paditesi mirtan Serica, qe paditesi i pranon ne kerkese padine e tij jane 196 kredite: Teza e diplomes, sipas rregullores mesimore te UART, vleresohet 30 kredite: Totali i krediteve, per paditesin Mirian Serica, rezultojne gjithsej 226 kredite. Për të përfituar një diplomë të integruar të nivelit të dytë, studenti duhet të ketë 300 kredite. Sipas llogarive paditesi



rezulton të ketë 226 kredite, pra edhe me këtë llogaritje të supozuar, paditësi nuk e përfiton këtë diplomë. Pra padia është e pambështetur në ligj dhe prova dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:


Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njehsues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 06.12.2013.

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimeve të paraqitura nga pala e paditur, sikurse ka vlerësuar drejt edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Proedurës Civile, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar pasivisht në padi, i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012(vendimet e paankimueshme).

Në funksion të analizës së shkaqeve të ngritura në këto ankime, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.1054 datë 03.03.2015, objekt ankimi, është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi.

Gjykata Administrative e Apelit, në analizë të shkaqeve të ngritura në ankimin e palës së paditur, akteve shkresore në dosjen gjyqësore dhe asaj sa gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar në vendimin e saj shtron për diskutim çështjen nëse duhet detyruar ose jo pala e paditur, Universiteti i Arteve që të pajisë paditësin Mirian Serica me diplomë të integruar të nivelit të dytë.

Sikurse rezulton nga aktet në dosjen gjyqësore: Në vitin akademik 2004-2005 paditësi Mirian Serica, ka filluar studimet pranë Fakultetit të Muzikës në programin e studimit piano, duke ndjekur ciklin katër vjeçar të studimeve prane Universitetit të Arteve, deri në vitin akademik 2010-2011. Pasi ka shlyer të gjitha provimet e parashikuara nga cikli i studimeve, paditësit i ka mbetur pa shlyer provimi i diplomës. Senati Akademik i Universitetit të Arteve ka marrë vendimin nr.21 datë 26.06.2012 "Për disa modalitete mbi përfundimin e studimeve nga studentët që nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e diplomës, për efekt të kalimit në sistemin e studimeve 3+2 në Universitetin e Arteve". Në bazë të këtij vendimi, Grupi i Vlerësimit të Krediteve të Fakultetit të Muzikës ka përcaktuar kreditet e paditësit për katër vite studimi në Fakultetin e Muzikës. Konkretisht me shkresën e datës 02.10.2012, paditësi është vlerësuar me 196 kredite. Në datë 05.02.2014, paditësi rezulton të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Për sa më sipër pasi ndjekjes së rrugës administrative në lidhje me sa kërkohet në objektin e padisë, paditësi i është drejtuar gjykatës duke pretenduar detyrimin e palës së paditur ta pajisë atë me diplomë të integruar të nivelit të dytë.



Në funksion të arritjes së një konkluzioni të drejtë lidhur me çështjen, Gjykata Administrative e Apelit referon në ligjin nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise". Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e misionit, objektivave kryesore të arsimit të lartë dhe rregullimin e aspekteve të krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit, sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet evropiane, si dhe rolin e shtetit e të shoqërisë në arsimin e lartë. Nëpërmjet këtij ligji është shfuqizuar ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Paditësi rezultoi të jetë regjistruar në programin e studimit pranë Fakultetit të Muzikës, në vitin akademik 2004-2005, pra në kohën kur ka qenë në fuqi ligji nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas ligjit nr.8461/1999, programi i studimit në këtë fakultet ka qenë katër vite akademike. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", ka ndryshuar programi i studimit si dhe diplomat e studimeve universitare. Por në këtë ligj janë parashikuar dispozita kalimtare, për studentët e regjistruar në një program studimi para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konkretisht në nenin 88 të këtij ligji parashikohet se: *Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij. Studentët mbetës do të marrin një diplomë në varësi të afateve të studimeve të tyre dhe kurrikulës.*

Të njëjtin përcaktim bën dhe neni 99/1 i ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", në të cilin parashikohet: *1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi, për kohëzgjatjen e parashikuar të tij, dhe në përfundim do të pajisen me diplomë, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në përshtatje me programin e studimit të kryer. 2. Institucionet e arsimit të lartë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtatin emërtimet e diplomave, që i përkasin programeve të studimeve në vijim dhe t'i depozitojnë për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.*

Sikurse rezultoi e provuar në datën 05.02.2014, paditësi rezultoi të ketë shlyer provimin e diplomës, ku është vlerësuar me notën 9 (nëntë). Për këtë fakt është mbajtur procesverbal i mbrojtjes së diplomave për ciklin e dytë "Master i Arteve të Bukura" viti akademik 2013-2014, duke i lindur në këtë mënyrë, e drejta për tu pajisur me diplomë.

Në lidhje me këtë procesverbal, pala e paditur në ankimin e parashtruar nga ana e saj ka pretenduar të jetë i pavlefshëm/i parregullt. Një pretendim të tillë gjykata e gjen të pabazuar, pasi nuk konstaton element të pavlefshmërisë apo parregullsisë së tij. Gjithsesi, edhe nëse do të pranohet pavlefshmërinë/parregullsinë e procesverbalit, gjykata vlerëson se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë paditësit. Me fjalë të tjera, rreziku i ndonjë gabimi të kryer nga autoritetet shtetërore, duhet të mbulohet nga shteti. Gabimet nuk duhet të paguhet nga individ i përfshirë në çështje (vendimi Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, çështja: Radchikov k. Rusisë, § 50).

Përsa i përket llojit të diplomës me të cilën duhet të pajisen studentët e regjistruar në programin e studimit katër vjeçar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741 dt. 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise", me të drejtë gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 89 të këtij

ligji, ku përcaktohet ekuivalentimi i diplomave, sipas kohës së zgjatjes së programeve të studimit.

Bazuar në përcaktimet e kësaj dispozite, diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, sic është dhe rasti i paditësit, janë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë. Duke qenë se studimet e paditësit kanë zgjatur katër vite akademike, në përfundim të të cilave është shlyer dhe provimi i diplomës, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë është arritur në konkluzionin se paditësit i lind e drejta që të diplomohet me diplomë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë.

Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur, referuar fakteve të mësipërme, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në këto pretendime rezulton të jenë paraqitur të njëjtat fakte dhe argumenta që janë paraqitur edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe asnjë argument shtesë përse analiza e rrethanave të faktit të bërë në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është e pabazuar në ligj e prova.

Konstatohet se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim u është dhënë zgjidhje në vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një analize të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit që janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analizë rezulton të jetë plotësisht e bazuar në kriteret e dispozitave përkatëse të përmendura në vendim.

Gjykata Administrative e Apelit nuk gjen shkaqe ligjore për të cënuar vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe për këtë arsye bazuar në nenin 50, shkronja "b" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshur, përfundimisht vlerëson se vendimi nr.1054 datë 03.03.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja "b" e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

VENDOSI :

- Lënien në fuqi të vendimit nr.1054 datë 03.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

-U shpall sot në Tiranë, më datë 17.02.2017

GJYQTARE

Bernina KONDI

GJYQTARE

Altina NASUFI

GJYQTAR

Kastriot SELITA

VËRTETOHET NJËSIA
ME ORIGJINALIN

KANCELARI

LEONARD STRATAJ